



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:099359

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730512

K.Dh.Sh.II.nr.638/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "Good Year" Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.408/2022, të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.408/2022, i datës 26.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.408/2022, të datës 26.01.2024, është vendosur Apropohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "Good Year" Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, Anulohet aktvendimi me nr. 01.3.2.2/4799 i datës 19.04.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. dhe Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit "Good Year" Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, t'ia kthej shumën prej 3,261.01€, (tremijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një euro e një cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-5934/23.02.2021 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore prej 8% nga data 23.02.2021 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovet ankesa në tërësi si të bazuar në ligj të priset aktgjykimi KF.nr.408/2022 i datës 26.01.2024 si i

pa bazuar në ligj, të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/4799 i datës 19.04.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Good Year” Sh.P.K - Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e vendimit R-5934/23.02.2021 të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/4799 të datës 19.04.2021, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, me arsyetimin se Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksioneve bankare ndërkombëtare të datës 13.10.2020, 25.11.2020 dhe 28.01.2021 në raport me pro faturën nr. HKGY-001-2020 dhe me faturën kontestuese HK-NTS-WWY-2011-2222A, ashtu që paditësi fillimisht ka pranuar një pro faturë me nr. HK-GY-001-2020 e datës 12.10.2020 me vlerë prej 97,891.20, malli i cili është pranuar më pastaj në tri fatura të ndryshme si HK-NTS-WWY-2011- 2222A faturë kontestuese dhe fatura jo kontestuese HK-NTS-WWY-2011-2222B dhe HK-NTSWWY-2011-2222C. Vlera e importuar përputhet me vlerën e përgjithshme të pro faturës HKGY-001-2020 datë 12.10.2020 dhe faturën në shumë dhe sasi e cila në shumën e përgjithshme ishte 97,891.20 dollarë. Transaksionet bankare ndërkombëtare në raport me numrat e faturave sipas DUD-ave kontestues dhe jo kontestues kanë përshkrim “Paymet for HK GY-001-2020”. Pjesa e zhdoganimit me pro faturën nr. HK-GY-001-2020 përveç faturës kontestuese HK-NTSWWY-2011-2222A janë edhe fatura jo kontestuese HK-NTS-WWY-2011-2222B dhe HK-NTSWWY-2011-2222C të cilat janë vërtetua me DUD-at përkatës E-11004 dhe R-11007. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se

të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së. Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës-zhdoganimet e mëhershme, në bazë të së cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se konstatimi i gjykatës se subjekti deklaratës doganore i ka

bashkangjitur faturën transaksionin bankar dhe kontratën e shitblerjes dhe se me këto janë të mjaftueshme që të aprovohet padia dhe të vlerësohet malli sipas metodës së parë të vlerësimit është konkluzion i gabuar dhe gjithashtu interpretim i gabuar i gjykatës. Me dispozitën e nenit 123 të UA për implementim të Kodit Doganor është paraparë se subjekti mund të paraqes në procedurë doganore vetëm faturë, por kjo nuk nënkupton se importuesit do t'i pranohet vlera e transaksionit të deklaruar. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se e paditura me vendimin kontestues nuk ka dhënë arsye dhe prova konkrete se përse e ka kontestuar vlerën e mallit si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga paditësi, kur ka konsideruar se vlera e mallit lëndor e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin, me qëllim të importit në vendin tonë. Tutje gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor dhe urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të cilat janë na harmoni të plotë në kuptim të shumës si në faturë. Në këto rrethana gjykata vlerëson se të gjitha dokumentet rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së. Gjukata vlerëson se dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parashihet deklarata eksportuese për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve që parashihet t'i bashkëngjiten DUD-ave gjatë zhdoganimit të mallit, të cilat me të drejtë ka vlerësuar se provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore sa i përket vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës financiare, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i

kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.638/24, me datë 24.05.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi